



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 201, Datë 30.09.2020

PËR MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT

Bazuar në nenin 65, pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në nenin 189, pika 1, germa “a” e Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë”, i ndryshuar, në kërkesën për dorëheqje nga detyra të znj. Rabiana Halili, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, nëpërmjet kërkesës së regjistruar me nr. 1448 prot, datë 28.09.2020, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak dorëheqje, të për znj. Rabiana Halili, me detyrë Prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.
2. Dorëheqja jep efektet në datë 02.10.2020.
3. Të njoftohet për këtë vendim znj. Rabiana Halili, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BËLURI

ANËTAR
BUJAR SHËSHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
ESMERALDA KESHI